

Grupi i Punës 1


Gjyqësori dhe të drejtat themelore



4 sesione u zhvilluan në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë që është dhe institucioni përgjegjës për negociatat e kapitullit 23.

Institucionet Pjesëmarrëse

Në Grupin e parë të Punës u përfshinë 62 institucione dhe 164 pjesëmarrës.



Kapitulli 23

Grupi i parë i punës u formua me qëllim që të nxjerrë rekomandime dhe konkluzione për ato fusha që janë vlerësuar si prioritet për Kapitullin 23, si sistemi gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore.

Periudha e zhvillimit të sesioneve

Nëntor 2020 - Qershor 2021

Rekomandimet:



- Arritja e standardeve dhe realizimi i reformave për Kapitullin 23, si dhe qëndrueshmëria duhet të jenë objektivat kryesore në këtë proces, dhe me rëndësi është që këto standarde të ruhen edhe pasi vendi arrin integrimin në BE.
- Duhet synuar bashkëpunimi i ngushtë dhe përfshirja e aktorëve jo-shtetërorë si shoqëria civile por edhe grupeve të tjera të interesit. Një bashkëpunim të ngushtë duhet të ketë dhe mes institucioneve shtetërore, si dhe me vetë institucionet e BE.
- Zbatimi i reformave thelbësore dhe transformuese si reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, rritja e transparencës dhe profesionalizmit duhet të vazhdojë, si dhe duhet të punohet edhe për informimin e ndërgjegjësimit e opinionit publik për këtë proces në mënyrë që ata të vazhdojnë ta mbështesin dhe të jenë të ndërgjegjshëm për kostot dhe përfitimet që vijnë nga ky proces.

www.eurokonventa.al